



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1160/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI16/17

Parashtrues

SHA "Emin Duraku"

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
AC-I-15-0297-A0001-A0002, të 16 shtatorit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga ndërmarrja SHA "Emin Duraku" Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Bejtush Isufi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Vendimin (në tekstin e mëtejshëm: Vendimi i kontestuar) e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i Apelit i DHPGJS), për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP), nr. AC-I-15-0297-A0001-A0002, të 16 shtatorit 2016.
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses më 25 tetor 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, me të cilin parashtruesja pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6, paragrafi 1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: Konventa).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 21.4 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 shkurt 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 11 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës i dërgoi Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKP-në.
9. Më 21 qershor 2017, Gjykata informoi gjithashtu AKP-në, për parashtrimin e kërkesës.
10. Më 24 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin paraprak të gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 19 gusht 1991, këshillat e punëtorëve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), morën vendim për transformimin e Korporatave të Biznesit dhe SHPK-ve vartëse në shoqërinë aksionare Holding "Emin Duraku" SHA. Ky vendim

bazohej në nenin 145, pika b) dhe nenin 196, pika g) të Ligjit për Ndërmarrjet (GZ e RSFJ-së nr. 77/88, 40/89).

12. Më 31 dhjetor 1991, parashtruesja e kërkesës u regjistrua si SHA në Gjykatën Ekonomike të Gjakovës.
13. Më 9 gusht 2000, parashtruesja e kërkesës u regjistrua me numër të përkohshëm të biznesit (80192983), në Zyrën e Regjistrimit të UNMIK-ut .
14. Më 19 nëntor 2002, parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë në Shoqatën e Avokatëve të Kosovës, Odën Ekonomike të Gjakovës, duke kërkuar mendimin profesional në lidhje me vlefshmërinë e transformimit të statusit nga ndërmarrja shoqërore në shoqëri aksionare, të kryer gjatë viteve 1991-1993.
15. Më 22 nëntor 2002, Shoqata e Avokatëve iu përgjigj kërkesës së parashtrueses së kërkesës, duke thënë se transformimi i ndërmarrjes ishte bërë në pajtueshmëri me Ligjin për Ndërmarrjet (Gazeta zyrtare e RSFJ-së, 77/1988).
16. Në fillim të vitit 2006, parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, duke kërkuar që kjo gjykatë ta urdhërojë Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për regjistrimin e NSH "Emin Duraku" në librat e bizneseve.
17. Më 24 maj 2006, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, aprovoi kërkesën e parashtrueses dhe urdhëroi Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, që NSH "Emin Duraku" ta regjistrojë në librin e bizneseve.
18. Më 13 korrik 2007, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) (paraardhëse e AKP-së), ua dërgoi ndërmarrjeve shoqërore të Gjakovës një propozim për reformimin e të gjitha ndërmarrjeve shoqërore (NSH-ve), përfshi parashtruesen e kërkesës.
19. Më 3 gusht 2007, ndërmarrjet shoqërore të Gjakovës ia dërguan një kundërpropozim AKM-së, me disa ndryshime të vogla.
20. Më 21 korrik 2008, parashtruesja e kërkesës ushtroi padi në DHPGJS-së, me kërkesë për njohjen e statusit të shoqërisë aksionare.
21. Më 29 prill 2010, Bordi i AKP-së nxori konkluzion se parashtruesja e kërkesës ka statusin e ndërmarrjes shoqërore.
22. Më 20 korrik 2010, parashtruesja e kërkesës i parashtrroi kërkesë Kolegjit shqyrtues të AKP-së për të anuluar vendimin e Bordit të AKP-së, të 29 prillit 2010.
23. Më 10 gusht 2010, Bordi i Drejtorëve të Degës së Ekzekutivit të Komunës së Gjakovës i propozoi AKP-së, që të pezullojë vendimin për privatizimin e ndërmarrjes "Emin Duraku" në valën e 45 A në pritje të përfundimit të procedurës së auditimit, pasi që kompania nuk i ishte nënshtruar procedurës së auditimit, apo deri sa të përfundojë procedura gjyqësore e iniciuar nga parashtruesja e kërkesës në DHPGJS.

24. Më 28 gusht 2010, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë në DHPGJS për vendosjen e masës së përkohshme, për të parandaluar AKP në shitjen e pronës dhe aseteve të tjera të parashtrueses së kërkesës, përmes valës së privatizimit.
25. Më 7 shtator dhe 4 tetor 2010, AKP vendosi që ndërmarrja NSH "Emin Duraku" të privatizohej përmes valës 45 A dhe 46 të privatizimit.
26. Më 13 shtator 2010, parashtruesja e kërkesës sërish parashtroi kërkesë në DHPGJS-së për vendosjen e masës së përkohshme, për të ndaluar AKP-në në shpalljen e tenderit për privatizimin e pronës dhe aseteve të parashtrueses së kërkesës, deri në përfundimin e procedurave gjyqësore.
27. Më 22 shtator 2010, DHPGJS-ja një kopje të kërkesës së parashtrueses ia dërgoi AKP-së për të dhënë përgjigjen e saj, e cila më 29 shtator 2010 e dorëzoi përgjigjen.
28. Më 8 tetor 2010, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (Kërkesa KI99/10) dhe kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të AKP-së, të 7 shtatorit 2010, përkitazi me privatizimin e ndërmarrjes përmes valës 45 A dhe 46. Njëkohësisht parashtruesja kërkoi nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme për të parandaluar privatizimin.
29. Më 2 nëntor 2010, DHPGJS-ja (Urdhri SCC-08-0237), miratoi kërkesën e parashtrueses për masë të përkohshme, deri sa e njëjta të vendoste me një vendim përfundimtar për çështjen. Kundër këtij vendimi AKP-ja parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.
30. Më 9 maj 2011, parashtruesja e parashtroi një tjetër kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (kërkesa KI65/11), për vlerësimin e Urdhrit SCC-0041 të DHPGJS, të 27 prillit 2011.
31. Më 19 maj 2011, Kolegji i Apelit i DHPGJS (Urdhri ASC-10-0088), miratoi ankesën e AKP-së dhe anuloi urdhrin e Trupit Gjyqësor të DHPGJS, duke e urdhëruar këtë të fundit, që sërish ta rishqyrtonte urdhrin për masë të përkohshme.
32. Më 2 mars 2011, parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë të re për masë të përkohshme për të pezulluar ekzekutimin e vendimit të AKP-së, të 9 prillit 2008, me të cilin ishte ndryshuar menaxhmenti i kompanisë Holding "Emin Duraku". Kërkesa e parashtrueses kishte të bënte me kthimin e menaxhmentit të mëparshëm dhe të gjithë punëtorëve në vendet e tyre të punës.
33. Më 4 mars AKP-ja, parashtroi përgjigje në kërkesën e 2 marsit 2011.
34. Më 27 prill 2011, DHPGJS kërkoi nga parashtruesja që të sqaronte kërkesën e saj dhe të sillte prova shtesë për të vërtetuar statusin e ekzistimit si person juridik.
35. Më 16 maj 2011, parashtruesja e kërkesës dorëzoi përgjigjen e saj në DHPGJS.
36. Më 23 gusht 2011, DHPGJS u informua se parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (Rasti, KI65/11) për vlerësimin e urdhrin të DHPGJS-së, të 27 prill 2011.

37. Më 28 shtator 2011, DHPGJS refuzoi kërkesën e parashtrueses për masë të përkohshme, për shkak se nuk kishte dorëzuar prova të mjaftueshme përkitazi me pretendimet e saj.
38. Më 31 tetor 2011, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në DHPGJS kundër aktvendimit të 28 shtatorit 2011.
39. Më 23 nëntor 2011, Gjykata Kushtetuese, vendosi që kërkesën e parashtrueses KI99/10 ta deklarojë të papranueshme për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike, duke refuzuar kështu edhe kërkesën për masë të përkohshme.
40. Më 17 gusht 2012, DHPGJS kërkoi nga parashtruesja që të dorëzonte kopjen e ankesës së 31 tetorit 2011, në gjuhën angleze.
41. Më 27 shtator 2012, parashtruesja e dorëzoi kopjen e ankesës në gjuhën angleze.
42. Më 15 tetor 2012, AKP-ja dhe UNMIK-u në emër të AKM-së parashtruan përgjigje në ankesë.
43. Më 21 janar 2013, Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën e parashtrueses së kërkesës KI65/11 të papranueshme, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike.
44. Më 15 dhjetor 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, me Vendimin SCC-08-0237, miratoi kërkesëpadinë e parashtrueses, duke ia njohur statusin e shoqërisë aksionare.
45. Më 30 dhjetor 2015, AKP-ja parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër vendimit të Kolegjit të Specializuar me arsyetimin se aktgjykimi ishte nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.
46. Më 16 shtator 2016, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së (Vendimi AC-I-15-0297-A0001-A0002), aprovoi ankesën e AKP-së dhe ndryshoi vendimin e Kolegjit të Specializuar me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës. Për më tepër, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konkludoi se me rastin e transformimit të ndërmarrjes nga ajo shoqërore në shoqëri aksionare nuk ishin respektuar kriteret dhe dispozitat ligjore të cilat ishin në fuqi.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

47. Parashtruesja e kërkesës pretendon se: *“Në rastin konkret aktvendimi i Gjykatës Ekonomike në Gjakovë Fi 4346/91 i datës 31 dhjetor 1991 është res judicata dhe këtë fakt e ka vërtetuar edhe shkalla e parë e Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës. Me këtë aktvendim ndërmarrjes i është dhënë statusi i shoqërisë aksionare. Mirëpo, në kundërshtim me këtë vendim të formës së prerë shkalla e dytë e Dhomës se Posaçme ka sjellë aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesën për njohjen e këtij statusi që ishte njohur më herët nga ana e gjykatës ekonomike. Për këtë arsye, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Kosovës, ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 6 të KEDNJ.”*

48. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës përkitazi me pretendimin e saj për shkeljen e të drejtave kushtetuese i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI51/11, të 19 qershorit 2012 dhe pretendon se rasti në fjalë duhet aplikuar ngjashëm edhe në këtë rast konkret.
49. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës nga Gjykata kërkon: *I. Të shpallë kërkesën të pranueshme. II. Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ... Të shpallë të pavlefshme Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës AC-I-15-0297-AOOOI-A0002 dhe ta kthejë çështjen në rivendosje.*

Pranueshmëria e kërkesës

50. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
51. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:
- “7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
52. Gjykata po ashtu i referohet nenit 21, paragrafit 4 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që parasheh:
- “4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*
53. Po ashtu, parashtruesja e kërkesës duhet të provojë se kërkesën e ka parashtruar në Gjykatë në pajtim me nenin 49 të Ligjit, që përcakton:
- “Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh (...).”*
54. Më tej, Gjykata vlerëson kriteret e kërkuara me nenin 48 të Ligjit, që përcakton:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*
55. Në bazë të dispozitave të sipërcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës vepron në cilësinë e personit juridik dhe është palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, ka dorëzuar kërkesën në pajtim me nenin 49 të Ligjit, ka përmendur saktësisht nenet e Kushtetutës me të cilat pretendon shkeljen e të drejtave të saj, si dhe autoritetin publik si shkelësin e të drejtave kushtetuese të saj.
56. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (3) (g) të Rregullores së punës, që parashohin:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

57. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me vendimin e vet ka ndryshuar vendimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, me të cilin ishte konfirmuar se vendimi i Gjykatës Ekonomike të Gjakovës Fi 4346/91, të 31 dhjetorit 1991, ishte *res judicata*, duke shkelur kështu nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës.
58. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së si çështje thelbësore e kishte trajtuar transformimin e kapitalit të kompanisë, duke nënvizuar faktin se: *“Shkalla e parë e ka konstatuar në mënyrë të gabuar thelbin e çështjes kontestuese. Çështja në fjalë nuk është vetëm dhe thjeshtë transformimi në strukturë dhe regjistrimi i NSH-së. Çështja themelore është nëse kapitali i kompanisë është transformuar në mënyrë të ligjshme nga pronësia shoqërore në atë private.”*
59. Gjykata vëren se argumenti i vetëm i parashtrueses së kërkesës në këtë rast është se Kolegji i Apelit i DHPGJS, nuk e njohu vendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Gjakovë, me të cilin ishte regjistruar parashtruesja si shoqëri aksionare.
60. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, duke arsyetuar pretendimin parashtrueses së kërkesës nëse vendimi i Gjykatës Ekonomike i viti 1991, për regjistrimin e ndërmarjes kishte efekt detyrues, vlerësoi se: *“vendimet gjyqësore për regjistrimin e organeve ligjore nuk kanë efekt detyrues dhe mund të kundërshtohen sikurse ka bërë AKM-ja dhe AKP-ja. Vendimi për regjistrim nuk miraton ndonjë parregullsi që ka ndodhur në procesin e transformimit pavarësisht nëse gjykata ishte në dijeni për të apo jo.”*
61. Për më tepër, Kolegji i Apelit i DHPGJ-së, theksoi se, *“... vendimet e Këshillit të Punëtorëve të datave 1 shtator 1990 dhe 19 gusht 1991 për transformim dhe vendimi pasues i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Gjakovë, Aktvendimi nr. Fi 4346/91, i datës 31 dhjetor 1991, për regjistrimin e transformimit do të konsiderohen pa efekt ligjor.”*
62. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJ-së erdhi në përfundim se *“Ky dështim ligjor e përcakton vlefshmërinë e të gjithë procesit të transformimit të NSH-së “Emin Duraku” në Shoqëri Aksionare”, duke arsyetuar se “Transformimi është një proces shumëfazësh ku vlefshmëria e secilit hap përcaktohet gjithashtu edhe nga vlefshmëria e hapave të mëparshëm. Një dështim thelbësor në një fazë e bënë të gjithë procesin të pavlefshmen edhe nëse nuk ka pasur dështime të tjera.”*

63. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës thjesht nuk është pajtuar me konkluzionet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, se vendimet e këshillit të punëtorëve dhe vendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Gjakovë, i 31 dhjetorit 1991 nuk prodhonin ndonjë efekt ligjor.
64. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, Kolegji i Apelit i DHPGJS në Aktgjykimin e tij adresoi të gjitha çështjet thelbësore që lidhen me pretendimet e parashtrueses së kërkesës. Konkluzionet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS u arritën pas shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha argumenteve të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës dhe nga AKP-ja. Në këtë mënyrë, parashtrueses së kërkesës i është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesë argumente dhe prova të cilat i kishte konsideruar të rëndësishme për rastin.
65. Për më tepër, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë konstatimit të fakteve apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
66. Vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i drejtë i ligjit është në juridiksionin e gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, shih po ashtu, Gjykata Kushtetuese rasti KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
67. Gjykata më tej vlerëson se të gjitha argumentet e palëve procedurale, që ishin të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, janë dëgjuar, shqyrtuar me kujdes dhe janë arsyetuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS. Andaj, shikuar në tërësi, Gjykata konstaton se procedurat e zhvilluara në Kolegjin e Apelit ishin të drejta nga aspekti kushtetues (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 29 dhe 30).
68. Përkitazi me pretendimin e parashtrueses së kërkesës, se në rrethana identike sikurse këto, Gjykata duhet të aplikoj aktgjykimin e saj në rastin KI51/11, Gjykata, konsideron se rrethanat e këtij rasti janë tërësisht të ndryshme, si për nga procedura ashtu edhe për nga përmbajtja. Kjo për faktin se në atë rast, çështja ishte gjykuar në substancë, sipas procedurës kontestimore nga Gjykata Komunale në Kamenicë, vendimi i së cilës ishte bërë i formës së prerë më 10 qershor 2009, pasi ishte konfirmuar dhe lënë në fuqi nga Gjykata Supreme. Megjithatë, në procedurën përmbartimore ekzekutimi i vendimit përfundimtar i Gjykatës Komunale të Kamenicës, ishte pezulluar nga Gjykata e Qarkut në Gjiilan, për shkak të ngritjes së një padie të re për pushimin e servitutit të parashtruesit. Në lidhje me pezullim të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë Gjykata gjeti se nuk kishte arsye për mosekzekutimin e vendimit *res judicata*, siç kishte vepruar gjykata përmbartuese e shkallës së dytë.

69. Si përfundim, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës, nuk ofrojnë dëshmi *prima facie* se asaj i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
70. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtrueses, në baza kushtetuese, duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe (2) (b), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, 4 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi